




RELACION

OBJEKTI: F.V PIRAMIDE ME XHAME NE HYRJE TE KINEMASE NETOKE NE PARKUN QENDROR, FIER



ADRESA:LAGJA "APOLLONIA" FIER

Objekti qe do te ndertohet eshte me konstruksion metalik, inoksi dhe xham i strukturuar 20 mm me elemet plastik te rrjetezuar ne mes. Struktura eshte piramide me baze te barabarte 5.6 ml dhe lartesi kulmi 4.5 ml. Është konceptuar me xham transparent te mbajtur me element spider te cilet jane te salduar ne profilet e inoksit.



Ne anen jugore te struktures eshte projektuar porta hyrese per ne kinema, eshte konceptuar me permasa 1.7m gjeresi dhe 2.2m lartesi me dy kanate te cilat kane nje kend hapje 180 grade, duke bere te mundur akses te shpejtë dhe te lehte ne strukture. Porta hyrese gjithashtu eshte me xham dopio 20mm i temperuar dhe laminuar. Konstruksioni i objektit eshte metal inoks me shufra qe bashkohen me me ane te saldimit. Ne kete konstruksion do saldohen elementet mbajtjes te xhamit te cilet jane element "spider" te cilat do te lidhin xhamin me strukturen

metalike inoks.



Objekti do te qendroj mbi nje platform betoni me me trashesi 10cm, dhe ne te do te behet i mundur inkastrimi i tij. Ne projekt jane parashikuar dhe element ndricimi, spote me llamp LED me fokus te cilat do te vendosen ne bazen e objektit dhe do ndricojne majen e saj. Gjithashtu eshte parashikuar dhe shirit LED te tipit RGB me komndim qendrorë i vendosur ne bazen e saj. Kjo strukture do sherbej per hyrjen ne ambientet e kinemase por njekohesisht perben dhe nje element dekorativ te vecantë qe qendron ne harmoni me pjesen tjeter te parkut. Forma e tille e struktures do te behet nje pike referimi ne zonen e parkut. Projekti eshte konceptuar funksional, i qendrushem dhe estetike duke qene ne perputhje të plote me manualet e projektimit dhe manualin teknik te ndertimit te objektit me struktura metalike dhe xham.

Konceptoi: Ark: ERIGELS MYRTAJ